



Kodi i Sjelljes për Furnitorin

Prezantimi

Telekom Albania si pjesë e Grupit OTE (Grupi OTE – pjesë e Grupit Deutsche Telekom) vepron në përputhje me [Kodin e Sjelljes të Grupit OTE](#) dhe [Statutin Social](#).

Bazuar në vlerat thelbësore të Grupit OTE që udhëheqin etikën e biznesit, angazhimet sociale dhe mjedisore, grupi OTE kërkon që Furnitori t'u përmbahet parimeve të listuara në këtë Kod (siç përcaktohen më poshtë), të cilat do t'i bashkangjiten kontratës që do të lidhet me të (në vijim "Kontrata").

Furnitori do të bëjë çmos që të zbatojë këto Parime gjatë gjithë periudhës së furnizimit. Ky Kod i Sjelljes së Furnitorit nuk ka për qëllim të zëvendësojë ligjet dhe rregullat në fuqi të vendit ku furnitorët e Grupit OTE ushtrojnë aktivitetin por ai kërkon të inkurajojë dhe të respektojë këto ligje dhe rregulla, dhe të sigurohet që ato zbatohen me besim dhe efektivitet.

PARIMET

1. Marrëdhënia me Legjislacionin Vendas dhe Ndërkombëtar

Përveç pajtimit me dispozitat e mëposhtme, të detajuara në seksionin 1 dhe 6 në vijim, Furnitori duhet të veprojë gjithmonë në përputhje me ligjet përkatëse në fuqi, dispozitat rregullatore dhe detyrimet kontraktuale, siç është rënë dakort midis Furnitorit dhe grupit OTE (në vijim "Palët"). Këtu do të përfshihen, Ligji Amerikan për Praktikën e Huaja Korruptive dhe Ligji kundër Rryshfetit në Mbretërinë e Bashkuar, në rastet kur këto janë të zbatueshme. Për më shumë, Furnitori duhet t'i bindet çdo sanksioni tregtar ndërkombëtar (përfshirë këtu edhe embargot) të cilat do të përfshijnë çdo sanksion që mund të jetë në fuqi si rezultat i kontratimit të rezolutës në zbatim të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, dhe çdo sanksion tjetër që mund të jetë vendosur nga BE. Palët bien dakort se, zbatim i Kodit të Sjelljes së Furnitorit është detyrim kontraktual primar i kontratës. Furnitori duhet të vendosë detyrim për kontraktorët dhe/ose nënkontraktorët e tij (në vijim "Nënkontraktorët") për të zbatuar parimet e Kodit të Sjelljes së Furnitorit për sa kohë që dhe ata janë të përfshirë në realizimin e furnizimeve të kërkuara në bazë të kontratës.

2. Parimet Themelore

Furnitori duhet të respektojë të drejtat e njeriut të shpallura ndërkombëtarisht dhe duhet të shmangë pjesëmarrjen në çdo lloj abuzimi me të drejtat e njeriut. Furnitori duhet të respektojë dinjitetin personal, privatësinë dhe të drejtat e çdo individ. Puna e detyruar dhe skllavëria, në të gjitha format e tyre, janë të ndaluara. Më tej, Furnitori duhet të zbatojë të gjitha standartet e parashikuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP).

3. Praktikën e Përgjegjshmërisë Sociale

3.1 Liria e Shoqërisë dhe e Drejta për Marrëveshje Kolektive

Furnitori duhet të përpiqet të zbatojë standartet e njohura ndërkombëtarisht, p.sh. Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, pa shkelur legjislacionin kombëtar.

Ai duhet të sigurohet që punonjësit dhe përfaqësuesit e tij, përfshirë edhe punonjësit e përkohshëm (nga agjenci punësimi) mund të shprehen hapur në kompaninë e tyre për qeshtje lidhur me kushtet e punës.

3.2 Puna e Fëmijëve

Puna e Fëmijëve ndalohet repretësisht. "Puna e Fëmijëve" është përkufizuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (OPN) në Programin Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (PNEPF) dhe në nenin 32 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve. Nëse ndonjë fëmijë gjendet duke punuar në ambientet e Furnitorit, ai duhet menjëherë të marrë masa për të korrigjuar situatën në përputhje me interesat më të mira të fëmijës.

3.3 Diversiteti dhe Mosdiskriminimi

Furnitori duhet të ndalojë dhe të luftojë diskriminimin bazuar në racë, ngjyrë, seks, orientim seksual, gjuhë, besim, opinion politik dhe opinione të tjera, kombësi apo shtresë shoqërore, pasuri, lindje apo status të tjera, dhe duhet të promovojë diversitetin, shanset e barabarta apo trajtim të barabartë në punësim dhe profesion. Furnitori duhet të trajtojë të gjithë punonjësit me respekt dhe nuk duhet të ushtrojë ndëshkim trupor, keqtrajtim fizik dhe mendor, si dhe asnjë formë abuzimi, ngacmimi apo kërcënimi për veprime të tilla.

3.4 Pagesa

Furnitori duhet të ofrojë pagesën sipas standarteve ligjore kombëtare të pagës minimale dhe të shmangë veprimin e uljes së pagës si masë disiplinore. Nëse nuk ekzistojnë standarte ligjore kombëtare, atëherë pagesa mjafton të plotësojë nevojat bazë të (OPN C131 – Konventa e Përcaktimit të Pagës Minimale). Baza mbi të cilën paguhen punonjësit u bëhet e qartë në kohën e duhur. Furnitori nuk do të ndër marrë veprime për uljen e pagës si masë disiplinore.

3.5 Orët e Punës

Orët e Punës duke përfshirë edhe orët jashtë orarit, duhet të jenë në përputhje me zbatimin e ligjeve vendase në fuqi. Nëse nuk ka standarte ligjore kombëtare, do të zbatohen standartet e OPN. Furnitori duhet të respektojë nevojat individuale të punonjësit për shlodhje apo shërim dhe të sigurohet që të gjithë punonjësit të gëzojnë të drejtën e largimit nga puna me pagesë.

3.6 Shëndeti dhe Siguria

Furnitori duhet t'u ofrojë punonjësve një vend pune të sigurt dhe të shëndetshëm dhe duhet të zbatojë programe efektive për të përmirësuar ambientin e punës në rastet kur kjo mund të jetë e nevojshme. Furnitori duhet të bëjë përpjekjet maksimale për të kontrolluar rreziqet dhe të marrë masat paraprake, të nevojshme kundër aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale. Furnitori duhet të ofrojë trajnime të përshtatshme dhe të rregullta, për t'u siguruar që punonjësit kanë njohuri mbi qeshtjet e shëndetit dhe sigurisë. Trajnimet duhet të përfshijnë dispozita dhe instruksione për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse. Furnitori duhet të sigurohet se, në rast se ofron akomodim, ai duhet të jetë i pastër, i sigurt

dhe përbush nevojat bazë të punonjësve dhe sipas rastit, edhe të familiarëve të tyre. Furnitori inkurajohet që të implimentojë Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë, bazuar në standartet ndërkombëtare, sic është OHSAS 18001 apo të tjerë të ngjashëm.

4. Praktikë e Përgjegjshmërisë Mjedisore

4.1 Mbrojtja e Mjedisit

Furnitori duhet të ketë një qasje parandaluese lidhur me sfidat mjedisore si (p.sh ndryshimi i klimës, biodiversiteti etj.), të ndërmarrë iniciativa për të promovuar një përgjegjësi më të lartë mjedisore dhe të inkurajojë zhvillimin dhe përhapjen e teknologjive të përshtatshme për mjedisin.

Furnitori duhet të veprojë në përputhje me standartet përkatëse mjedisore vendase dhe ato të njohura ndërkombëtarisht, si dhe me ligjet vendase në fuqi, nëpërmjet të cilëve do të aplikohet standarti më i lartë, duke përfshirë në mënyrë të veçantë Kufizimin e Substancave të Rrezikshme dhe Mbetjet e Pajisjeve Elektrike dhe Elektronike (sipas jepet më në detaje në Kontratën përkatëse).

Furnitori duhet të minimizojë ndikimin në mjedis dhe duhet të zbatojë masa që kontribuojnë në parandalimin e ndotjes dhe mbrojtjen e mjedisit.

Grupi OTE pret nga Furnitori që të ndjekë rregullat e ekonomisë cirkulare gjatë gjithë ciklit të jetës së produktit: konceptimin, zhvillimin, prodhimin, transportin, përdorimin dhe asgjësimin dhe/ose riciklimin. Furnitori duhet të minimizojë ose të përpiqet të shmangë emetimet e dëmshme në ajër, konsumin e energjisë dhe emetimin e dioksidit të karbonit. Në veçanti, Furnitori duhet të zhvillojë produkte dhe shërbime që kanë konsum të ulët të energjisë dhe emetim të ulët të dioksidit të karbonit gjatë gjithë ciklit të jetës.

Furnitori duhet të sigurojë dhe t'ju përmbahet të gjitha lejeve të nevojshme dhe të përpiqet për zbatimin e një Sistemi Menaxhimi Mjedisor të bazuar në standarte ndërkombëtare siç është ISO 14001.

4.2 Burimet Natyrore dhe Menaxhimi i Mbetjeve

Furnitori duhet të kufizojë përdorimin e materialeve dhe burimeve, përfshirë edhe ujin, gjatë përfundimit apo prodhimit të mallrave me qëllim minimizimin e ndikimit në mjedis.

Furnitori inkurajohet të gjurmtojë nëse burimi i mineraleve është në zonë konflikt, të promovojë transparencë gjatë gjithë zinxhirit të furnizimit dhe të vendosë masa për këtë qëllim.

Përdorimi i burimeve të rralla duhet të kufizohet ose të shmangët kur është e mundur. Mbetjet e krijuara nga i gjithë aktiviteti i tij duhet të identifikohen, monitorohen dhe manaxhohen. Furnitori duhet të përpiqet të reduktojë mbetjet. Trajtimi i mbetjeve duhet të bëhet në përputhje me ligjet mjedisore në fuqi.

5. Praktikë Biznesi të Ndaluar

5.1 Anti-Korrupsioni

Furnitori duhet t'i shmangët çdo formë korrupsioni apo veprimeve që potencialisht mund të konsiderohen të tilla. Furnitori nuk duhet të ofrojë, premtojë apo dhurojë benefite të paligjshme zyrtarëve publikë vendas dhe ndërkombëtarë, ose vendim-marrësve që operojnë në sektorin privat, me qëllim

përfitimin e trajtimit preferencial ose favorizimit në vendime; e njëjta gjë vlen edhe kur kemi të bëjmë me donacione, dhurata apo ftesa për një drekë/darkë pune dhe evente. Furnitori nuk duhet t'ia lejojë vetes t'i premtohen apo ofrohen avantazhe, dhe as nuk duhet t'i pranojë ato, nëse kjo gjë mund apo do t'i krijojë përshtypjen palës dhuruese që ajo mund të influencojë në vendimet e biznesit. Gjithashtu, furnitori nuk duhet të kërkojë avantazhe.

Furnitori duhet të shmangë konfliktin e interesit, që mund të çojë drejt mundësisë për korrupsion. Nëse Furnitori është klient i Grupit OTE, nuk duhet të marrë avantazhe të padrejta dhe duhet që prokurimin dhe shitjet t'i mbajë qartësisht të ndara. Furnitori merr përsipër dhe ju kërkon drejtorëve, nëpunësve, punonjësve, furnitorëve, filialeve, nënkontraktorëve të tij dhe çdo përfaqësuesi përkatës (në vijim "Palët e Treta"):

- të respektojnë rregullat e seksionit 5.1 sëbashku me rregulloret e përcaktuara në Seksionin 1 ("Rregullat"), me mjete të përshtatshme për zbatimin efektiv dhe mirëmbajtjen e kuadrit të pajtueshmërisë;
- që (i) Palët e Treta të përfshira në zbatimin e Kontratës veprojnë në përputhje me Rregullat dhe që (ii) çdo mjet i nevojshëm i përdorur nga Palët e Treta për zbatimin e Kontratës është në përputhje me Rregullat.

Në mënyrë që të sigurojë pajtueshmërinë me Rregullat për gjithë kohëzgjatjen e kontratës, Furnitori duhet t'i vërë në dispozicion Grupit OTE, me kërkesë dhe gjatë gjithë kohës, të gjithë elementët që kërkohen për vendosjen e kësaj pajtueshmërie dhe duhet të njoftojë Grupin OTE pa asnjë vonesë, kur është në dijeni ose ka arsye të jetë në dijeni, për ndonjë rast mosveprimi në përputhje me Rregullat, nga ai vetë apo nga Palët e Treta, si dhe për masat korrigjuese të marra për të siguruar pajtueshmërinë me Rregullat.

Një shkelje materiale e pajtueshmërisë me Rregullat mund të çojë në lindjen e një të drejte për zgjidhje kontrate, sipas parashikimeve të saj.

5.2 Konkurrenca

Furnitori duhet të respektojë rregullat e konkurrencës së lirë dhe të drejtë në të gjitha marrëdhëniet e biznesit, në veçanti nuk duhet të veprojë në kundërshtim me ligjin e konkurrencës dhe/ose me ligjin antitrust.

5.3 Sponzorizimi

Të gjitha sponzorizimet e Furnitorit duhet të jenë në përputhje me legjisllacionin përkatës në fuqi.

5.4 Kontributet Politike

Furnitori nuk duhet t'i dhurojë para apo përfitime monetare një partie politike, përveçse kur kjo lejohet me ligj.

5.5 Pastrim Parash

Furnitori duhet të marrë të gjitha masat për parandalimin e pastrimit të parave brenda sferës së tij të ndikimit.

5.6 Siguria dhe Mbrojtja e të Dhënave

Furnitori duhet të zbatojë të gjitha ligjet në fuqi për mbrojtjen e të dhënave si dhe të gjitha kërkesat specifike për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave, të dakortësuara në Kontratë.

6. Monitorimi dhe Auditimi Social, Mjedisor dhe i Pajtueshmërisë

Në mënyrë që të sigurojë pajtueshmërinë me Parimet e përcaktuara në Kodin e Sjelljes së Furnitorit për gjithë kohëzgjatjen e Kontratës, Furnitori duhet të vërë në

dispozicion, sipas kërkesës, të gjithë elementët e kërkuar për garantimin e kësaj Pajtueshmërie dhe duhet të informojë Grupin OTE, pa asnjë vonesë, kur është në dijeni ose ka arsye të jetë në dijeni, për ndonjë rast mosveprimi në përputhje me Parimet, nga ai vetë apo nga një Nënkontraktor, si dhe për masat korrigjuese të marra për të siguruar pajtueshmërinë me Parimet.

Në rast të amendimit të kuadrit ligjor dhe/ose rregullator, si dhe në rast të ndonjë vendimi juridik që do të përfshinte shkeljen e Parimeve nga njëra nga Palët, Grupi OTE mund të njoftojë amendimet përkatëse, që duhet të implementohen nga Furnitori.

Nëse nuk përcaktohen në Kontratë, për Auditimin Social, Mjedisor dhe të Pajtueshmërisë do të zbatohen detyrimet e mëposhtme: Grupi OTE, dhe/ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, kanë të drejtë të kryejnë aktivitete monitorimi kundrejt Furnitorit dhe Nënkontraktorëve të tij, për të vlerësuar pajtueshmërinë reale të Furnitorit dhe Nënkontraktorëve me Parimet. Kjo përfshin të drejtën e Grupit OTE, dhe/ose përfaqësuesit të tij të autorizuar, për të kryer auditime që përfshijnë inspektime në vend, pyetësorë dhe/ose intervista me punonjësit e përzgjedhur në ambientet e Furnitorit, në terrenet e ndërtimit dhe/ose në vendndodhje të tjera ku po realizohet puna në emër të Furnitorit. Furnitori pranon se Grupi OTE ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë informacione të mëtejshme, (p.sh.përmes sistemeve të vlerësimit EcoVadis/E-TASC/vetëvlerësime të Grupit OTE) nëse konsiderohet e nevojshme. Me kërkesë të Grupit OTE, Furnitori do të informojë Grupin OTE për masat e miratuara për të siguruar pajtueshmërinë me Parimet. Në rast të mosveprimit në përputhje me Parimet, çdo mospërputhje duhet t'i raportohet Grupit OTE, dhe do të ndiqet nga një plan përmirësimi i dedikuar, i cili duhet të implementohet në kohën e duhur.

Për më shumë informacion apo sqarime lidhur me parimet e këtij Kodi, ju mund të përdorni kanalet e komunikimit të dhëna më poshtë:

Telekom Albania sh.a.

Zyra e Pajtueshmërisë dhe Auditit të Brendshëm

Rruga Gjergj Legisi, Laprakë, Tiranë

Tel: +35542275321

Email: complianceoffice@telekom.com.al

Internet: <https://www.telekom.com.al/company/compliance/>